



Thirrja është e hapur nga data 26.06.2025 deri me 03.07.2025

TERMAT E REFERENCES

KOMPANI DIZAJNUESE

Të dhënat mbi OJQ “Nevo Koncepti” dhe kërkesat për shërbimin e kampanjës .

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI
Objektiva	Realizimi i kampanjës për Asamblenë Komunale të Fëmijëve Prizren mbi temën ‘Zëri ynë, E Ardhmja jonë’.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financiar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulëta të komunës së Prizrenit.

Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 Asamblesitë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtat të Fëmijëve.



3. OBJEKTIVA

Qëllimi i këtij angazhimi është të kontraktohet një kompani dizajni kreative dhe me përvojë, e cila do të zhvillojë identitetin vizual dhe materialet promovuese për fushatën “Zëri ynë, e ardhmja jonë”. Fushata ka për qëllim të promovojë pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në çështje që lidhen me mjedisin, komunitetin dhe bashkëpunimin me institucionet. Ideja e fushatës hartohet nga vetë fëmijët dhe synon të përçojë mesazhin e tyre në mënyrë të fuqishme, kreative dhe vizualisht tërheqëse. Kompania do të mbështesë këtë proces përmes krijimit të materialeve grafike (posterë, infografika, përmbajtje për rrjete sociale, video të shkurtra etj.) që reflektojnë vizionin dhe zërin e fëmijëve, duke nxitur ndërgjegjësim dhe angazhim më të gjerë nga publiku dhe institucionet përkatëse.

Nevo Koncepti po kërkon të angazhojë një kompani kreative të dizajnit për të mbështetur zhvillimin dhe realizimin vizual të fushatës “Zëri ynë, e ardhmja jonë”.

4. DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE AFATI KOHOR

Angazhimi duhet të fillojë me datën 04.07.2025 dhe të planifikohet të përfundojë deri më 20 korrik, të gjitha materialet punuese duhet të dorëzohen tek Menaxheri i Projektit.

Nr.	Detyrat	Afati Kohor
1.	Përgaditja e materialit për prezantim dhe përgjatë punëtorisë të mbështetët AKF Prizren në krijimin e idesë për kampanjën.	Korrik 2025
2.	Takimi me Asamblenë Komunale të Fëmijëve, bashkëpunimi në grupe me antarët e Asamblesë, dhe draftimi i planit vizual të fushatës bashkë me antarët e AKF Prizren.	Korrik 2025
3.	Dorëzimi i planit final dhe materialeve promovuese tek menaxheri i projektit	20 Korrik 2025

5. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet ti dërgojnë këto dokumente:

Aplikacionet duhet të dërgohen duke përfshirë këto dokumente:

- Kuptimi i detyrës dhe nëndetyrave të saj;
- Metodologjia;
- Propozimi financiar ;
- Curriculum Vitae (për individë);
- Certifikata e biznesit dhe referencat (për kompanitë).

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 03.07.2025** në prokurimi@nevokoncepti.org.